

ASC-09-0029

Në padinë e

1. [REDACTED] *Paditësit*
(Përfaqësuar nga [REDACTED]
[REDACTED]; adresa [REDACTED]
Prishtinë)
Përfaqësuesi ligjor: [REDACTED]
2. [REDACTED]
Ndërmarrje Private (Përfaqësuar nga [REDACTED]
[REDACTED] address [REDACTED]
[REDACTED] Fushë Kosovë)
Përfaqësuesi ligjor: [REDACTED]
[REDACTED] Lipjan)
3. [REDACTED]
Ndërmarrje Private (Përfaqësuar nga [REDACTED] numri
i regjistrimit të biznesit: i panjohur; adresa: [REDACTED]
[REDACTED] Prishtinë)
Përfaqësuesi ligjor: [REDACTED].
Prishtinë)
4. [REDACTED]
Ndërmarrje Private
(Përfaqësuar nga: Bekim Vokrri; numri i regjistrimit të
biznesit: [REDACTED] adresa: [REDACTED] Prishtinë)
Përfaqësuesi ligjor: Shemsi Uka [REDACTED]
Prishtinë)
5. [REDACTED]
(adresa: e panjohur, Shtime)
Përfaqësuesi ligjor: [REDACTED]
Prishtinë)

Kundër

1. [REDACTED] *Të Paditurit/Ankuesit*
[REDACTED], Ndërmarrje Shoqërore, (Përfaqësuar nga
[REDACTED] numri i regjistrimit të biznesit: i panjohur;
adresa [REDACTED] Prishtinë) Përfaqësuesi Ligjor:
[REDACTED] Prishtina)

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit
(adresa: rr. Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë)

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 3 qershor 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ankesat e të Paditurve janë të bazuara. Aktvendimi i Trupit Gjykues në lëndët e bashkuara SCC-05-0080, SCC-06-0029, SCC-06-0470, SCC-06-0482 dhe SCC-06-0524 (të datës 2 qershor 2009) është ndryshuar. Kërkesa e Paditësit të parë dhe të katërt për të lëshuar ndalim të përkohshëm është refuzuar si e pabazë.**
- 2. Me rastin e Ankesave, Kolegji i Ankesave pohon se aktvendimi i Trupit Gjykues për ta ftuar AKP-në si të Paditur të 2-të në padi nuk ka efekt ligjor.**
- 3. Paditësi i parë është i obliguar që të paguaj 184, 80 Euro dhe Paditësi i katërt është i obliguar që të paguaj 95,20 Euro si taksë gjyqësore DHPGJS-së për procedurën ankimore.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Paditësit janë duke kërkuar kompensimin për dëmin që u është shkaktuar kur depot që ata kanë mbajtur me qira nga i Padituri i parë janë djegur nga zjarri më 25 shkurt 2000.

Më 18 shkurt 2008 i Padituri i Dytë (AKP-ja) ka shprehur synimin e vet për t'u bashkuar në padinë në anën e të Paditurit. I padituri i dytë gjithashtu ka propozuar suspendimin e procedurave në pajtim me Nen.278.2 të ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës (më poshtë i referuar si

LPK, Ligji nr. 03/L-006). I Padituri i dytë e ka përsëritur parashtresën e vetë gjatë seancës publike dëgjimore që është mbajtur nga ana e Trupit Gjykses më 19 shkurt 2009. Palët nuk kanë kundërshtuar propozimin për t'ju bashkuar të paditurit, mirëpo Paditësit kategorikisht kanë kundërshtuar pezullimin. Më 21 maj 2009 Trupi Gjykses ka lejuar që i Padituri i dytë t'i bashkohet në padi dhe në të vyejtën kohë ka refuzuar kërkesën për pezullim.

Më 4 maj 2009 Paditësi i parë dhe i katërt kanë kërkuar nga Trupi Gjykses që të lëshojnë një ndalim të përkohshëm duke ndaluar të Paditurin e dytë nga shitja, transferimi apo ndërrimin e pronësisë së të Paditurit të parë dhe/apo asetet e tij deri sa gjykata të lëshoj aktvendimin e vet përfundimtar.

Kërkesa është dorëzuar tek i Padituri i dytë më 25 maj 2009 duke e udhëzuar që të përgjigjet në kërkesë jo më larg se me datën 1 qershor 2009. I Padituri i dytë nuk iu ka përmbajtur urdhrit deri më datën e fundit.

Më 2 qershor 2009 Trupi Gjykses ka lëshuar ndalimin e përkohshëm ashtu siç është kërkuar, duke urdhëruar se qëndron fuqi deri në gjykimin përfundimtar të lëndës.

Trupi Gjykses ka argumentuar se nëse i Padituri i dytë do të shiste apo transferonte pronësinë e të Paditurit të parë, Paditësit nuk do të mund të merrnin më kompensimin e tyre.

Më 19 qershor 2009, të Paditurit të dytë dhe më 22 qershor 2009 të Paditurit të parë iu është dorëzuar ndalimi. Më 29 qershor 2009 i Padituri i parë dhe më 30 qershor 2009 i Padituri i dytë, kanë ushtruar ankesa të ndara pranë DHPGJ-së kundër ndalimit të përkohshëm.

Të dyja ankesat argumentojnë që Aktvendimi i Trupit Gjykses nuk është në pajtim me Nenin 55 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Të dy Ankuesit pretendojnë se Paditësi i parë dhe i katërt nuk kanë dëshmuar që dëmi apo humbja e

menjëhershme dhe e pariparueshme do të rezultonte në rast se kërkesa për ndalim të përkohshëm nuk do të jepej.

Për më tepër, i Padituri i dytë gjithashtu ka vënë në pikëpyetje legjitimitetin e një kërkesë të tillë, duke pohuar se kërkesa për kompensim duhet të trajtohet nga komisioni për Likuidim për të Paditurin e parë në një fazë të më vonshme.

I Padituri i dytë argumenton se një ndalim i tillë i përkohshëm thellësisht e ndalon procesin e privatizimit si të tillë dhe prandaj nuk mund të lëshohen brenda një kërkesë për dëme.

Arsyetimi Ligjor

Bazuar në Nenin 63.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6 Kolegji i Ankesave ka vendosur që ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Ankesat janë të pranueshme dhe të bazuara.

Pranueshmëria:

I Padituri i dytë, edhe pse nuk ka legjitimitet pasiv në lidhje me padinë në procedurën kryesore, ka të drejtën për parashtuar një ankesë, pasi që ka bartur pasojat nga aktvendimi i atakuar.

Pasi që Gjykata ka nxjerr në pah më parë (ASC-09-0108, aktvendimi i datës 09 shkurt 2010) nuk ekziston asnjë arsyetim i vlefshëm ligjor për ta thirr Agjencinë Kosovare të Privatizimit si një të Paditur tjetër në çfarëdo gjykimi nëse padia ka të bëjë vetëm me lidhjet ligjore të NSH-së me ndonjë person tjetër fizik apo juridik, pasi që AKP-ja për shkak të mandatit të vetë vepron "vetëm" si përfaqësuese (dhe vetëm në ato lëndë kur ajo vendos që të veprojë kështu), prandaj në emër të NSH-së në procedurat gjyqësore, që nuk ndikon fare në legjitimitetin aktiv dhe / apo integritetin ligjor të NSH-ve.

Aktvendimi i Trupit Gjykses për ta thirr të Paditurin e dytë si të tillë në gjykim ka qenë pa ndonjë rëndësi ligjore. Për arsye të thjeshtësimit, AKP-ja në këtë aktvendim do të referohet akoma si i Padituri i dytë.

Pasi që i Padituri i dytë me aktvendimin e atakuar është urdhëruar nga ana e Trupit Gjykses që të përmbahet nga çdo veprim që ndikon statusin ligjor të NSH-së, AKP-ja ka bartur pasojat nga ky aktvendim dhe prandaj ka të drejtën e ankimit kundër tij.

I padituri i parë ka bartur pasojat nga ky aktvendim pasi që dukshëm ndërlihet me statusin ligjor dhe "fatin e vet ligjor" në të ardhmen.

Ankesat janë të bazuara:

Kriteret për të lëshuar një ndalim të përkohshëm dalin nga Neni 55.1 i UA të UNMIK-ut 2008/6: pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për masë të përkohshme. Këto kritere janë dhënë në atë mënyrë që në se njëra prej tyre mungon atëherë kërkesa do të refuzohet.

Paditësit e parë dhe të katërt nuk kanë ofruar asnjë dëshmi për të mbështetur kërkesën e tyre, edhe pse deklaratat e tyre janë kontestuar nga të Paditurit. Ato nuk kanë përcaktuar që në një moment të caktuar kohor kompensimi i Paditësve do të rrezikohej nga veprimet e të Paditurit të dytë, veprime të cilat ata dëshironin t'i shihnin të ndaluara me anë të ndalimit të përkohshëm për të cilin ata kishin aplikuar. Ata nuk kanë paraqitur – dhe as nuk kanë deklaruar – asnjë indikatorë, për shembull për ndonjë likuidim të planifikuar apo privatizim të NSH-së, që do të mund të kuptohej si një ndryshim i rëndësishëm, i cili do të mund të shpinte drejt nevojës për të lëshuar një ndalim të tillë të përkohshëm.

Për më tepër, Paditësit veçse kanë – në pajtim me paditë e tyre – pësuar dëm në kohën e incidentit të zjarrit; rrjedhimisht nuk ka ndonjë rrezik që ata mund të vuajnë ndonjë dëm të ri dhe apo të drejtpërdrejtë. Duhet të thuhet qartë se instrumenti ligjor i ndalimit të përkohshëm nuk ka për qëllim të sigurojë plotfuqishmërinë e një aktvendimi të mundshëm në të ardhmen në lëshimin e dëmeve, mirëpo vetëm për t'ju shmangur një ndryshimi të pakthyeshëm në gjendjen ligjore apo faktike për një të drejtë apo posedim, që i nënshtrohet padisë kryesore që gjykata duhet të trajtojë.

Me përjashtim të elementeve të përmendura më sipër, humbja apo dëmi i mundshëm do të duhej të ishin të pariparueshme, që në rastin në fjalë dukshëm nuk është fakti, ashtu si Ankuesit kanë potencuar. Paditë kërkojnë kompensim monetar, që nga natyra e vet e veçantë nuk mund të konsiderohet e pariparueshme. Për më tepër, Paditësit mund të kompensoheshin nga të ardhurat e privatizimit që do të ndodhte në të ardhmen, e që do të zëvendësonte asetet aktuale të Paditurit të parë.

Për më tepër, përkrahja e ndalimit të përkohshëm mund të shpie drejt rrethanave të caktuara tek mos kualiteti në mes të kreditorëve të Paditurit të parë. Sa i përket natyrës ligjore, paditë e ngritura nga Paditësit nuk janë të ndryshme nga ndonjë padi tjetër kundër të Paditurit të parë. Nëse ndalimi i përkohshëm do të përkrahej, kjo do të ndikonte ashpërsisht në mundësinë e ekzekutimit të padive të tjera të mundshme.

Duke përmbledhur argumentet e sipër shënuara, pasi që asnjë nga kriteret e nevojshme për të lëshuar një ndalim të përkohshëm të përcaktuar me anë të dispozitës së cituar të ligjit nuk është përmbushur, aktvendimi i Trupit Gjykues për të lëshuar ndalimin e përkohshëm të kërkuar, duhet të anulohet dhe kërkesa duhet të refuzohet.

Shpenzimet:

Sipas Nenit 11 të REG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA 2008/6, Trupi Gjykses duhet të vendos në ndarjen e shpenzimeve në shkallën e parë, dhe Kolegji i Ankesave – kur të vendos përfundimisht në lëndën – në ndarjen e shpenzimeve të procedurave në të dyja shkallët.

Sipas Nenit 57.2 të UA 2008/6 të UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaçme ka lëshuar Rregulla Shtesë Procedurale në lidhje me Taksat Gjyqësore, në fuqi prej datës 10 mars 2010. Aty lexohet si në vijim:

‘Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, në lidhje me “Tarifat e Taksave Gjyqësore”, me anë të kësaj – me specifikime të mëtutjeshme – shpallet se është e aplikueshme për procedurë gjyqësore pranë DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri tek Neni 10.23 janë – mutatis mutandis – të aplikueshëm për procedurën ankimore pranë Trupit Gjykses dhe pranë Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, Neni 10.11 është gjithashtu i aplikueshëm për procedurën që udhëheq ankesën kundër aktvendimit të shkallës së dytë të Trupit Gjykses.

(...)

Këto Rregulla Procedurale shtesë hyjnë në fuqi më 10 mars 2010 dhe janë të vlefshme deri më 31 dhjetor 2010.’

Tarifat gjyqësore në të dyja shkallët përbëhen nga njëra anë nga një tarifë për ushtrimin e parashtresës (-ave), në anën tjetër nga një tarifë për lëshimin e (një) aktvendimi (-eve).

Pasi që aktvendimi në shkallën e parë është lëshuar para ditës kur rregullat e sipërpërmendura kanë hyrë në fuqi, këtu duhet të merren në trajtim vetëm tarifat gjyqësore për procedurat ankimore:

Shuma e tarifës për ushtrimin e ankesës ashtu siç parashihet me Neni 10.11 i Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30 euro.

Shuma e tarifës për lëshimin e aktvendimit siç parashihet me nenin 10.17, 10.2 dhe 10.1 të ADJ duhet të përcaktohet në bazë të vlerës së padisë. Vlera e padisë së përbashkët e të Paditurit të parë dhe të katërt është 195.000 Euro + 101.500 Euro = 296.500 Euro. Tarifa për aktvendimin e shkallës së parë për paditë që kalojnë vlerën prej 10.000 Euro është 50 Euro plus 0.5% deri në 500 Euro. Tarifa gjyqësore në lidhje me ndalimin e përkohshëm është 50% e shumës që do të paguhej për aktvendimin e shkallës së parë. Pasi që tarifa gjyqësore për një padi me vlerë prej 296.500 euro tejkalon 500 euro, 500 euro duhet të përpjesëtohen me 2 në mënyrë që të llogaritet tarifa gjyqësore për aktvendimin ankimor për ndalimin e përkohshëm në fjalë.

Pasi që paditë janë bashkuar nga DHPGJS-ja në procedurën e shkallës së parë, tarifat gjyqësore janë llogaritur në pajtim me shumën e bashkuar, por duhet të paguhet nga Paditësit duke marrë në konsideratë vlerën e padive individuale në lidhje me vlerën e përgjithshme të padisë së përbashkët. Pasi që vlera e padive të përbashkëta tejkalon vlerën maksimale për llogaritjen e tarifave gjyqësore, shuma totale ësh 250 € plus 30 € si tarifë ankimore.

Në pajtim me atë që u tha më sipër, Paditësi i parë do të paguaj 184, 80 euro (bazuar në vlerën e padisë së tij 195.000 Euro).

Paditësi i katërt do të paguaj 95,20 euro (bazuar në vlerën e padisë së tij 101.500 Euro).

Në përgjithësi tarifat gjyqësore duhet të paguhet nga ana e palës që e humb lëndën, me përjashtim të atyre lëndëve ku lënda duhet të kthehet për rigjykim nga ana e Trupit Gjykues (apo, kur Kolegji i Ankesave është në cilësinë e shkallës së tretë, qoftë nga Gjykata Komunale apo nga Trupi

Gjykues). Në ato raste, shpenzimet duhet të kryhen në baza të përkohshme nga ana e Ankuesit dhe ndarja përfundimtare e shpenzimeve i takon trupit gjykues në aktvendimin e vet të ri. Në lëndët e tilla siç është lënda në fjalë, ku Kolegji i Ankesave përfundimisht refuzon një kërkesë për ndalim të përkohshëm, shpenzimet duhet të paguhen nga pala që ka kërkuar ndalimin e përkohshëm.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues
EULEX

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar
EULEX

Eija-Liisa Helin, Gjyqtar
EULEX

Tobias Lapke, Regjistruer
EULEX
